




Pranuar / Dorezuar Priljenor/Prodato Received/Deliverty	16.04.2021	1	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtypja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHICK	1840/2021		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Nezavisni Nadzorni Odbor Civilne Službe Kosova
Independent Oversight Board for the Civil Service of Kosovo

A.nr. 233/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës i përbërë nga: Arben Mehmeti- kryetar, Ardita Haxhnikaj Demi dhe Eshref Shabani- anëtarë, si dhe Rushit Kajtazi, Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2345/2019, të datës 15.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën A.nr.370/2019, të datës 02.07.2019, të ankuesit me adresë banimi rruga „ Sheshi Nëne Tereza“, Nr. 32/1A nga Komuna e Prishtinës, me përfaqësueses juridik avokatin Ekrem Agushi, kundër organit të punësimit Këshilli i Sigurisë së Kosovës, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në pajtim me Rregulloren 02/2018, për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 16.04.2021, mori këtë

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa A.nr. 370/2019, e datës 02.07.2019, e parashtruar nga ankuesi

II. Anullohet Vendimi Nr.181/2019 i datës 27.05.2019, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, si dhe Vendimi i datës 26.03.2019, me numër protokolli 091/2019, i Komisionit Disiplinor.

III. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës dhe Menaxheri i Personelit për zbatimin e këtij vendimi duke përfshirë edhe kompensimin e mjeteve financiare të ndalur sipas vendimeve të anuluar në pikën II të këtij vendimi, në afatin prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, me datën 27.02.2019, ka dërguar e-maili tek Zyrtarja e Personelit e Këshillit të Sigurisë së Kosovës, duke e njoftuar për hapjen e procedurës disiplinore ndaj nëpunësit civil

Komisioni Disiplinor i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, me datë 26.03.2019, me numër protokoll 091, ka nxjerr vendim me të cilin ka shqiptuar masën disiplinore „Pezullim i ushtrimit të detyrës dhe ndalim i 1/3 të rrogës për periudhën një (1) mujore.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 26.03.2019, me numër protokoll 091/2019, të Komisionit Disiplinor, me datë 24.04.2019, me ankesë i është drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshilli i Sigurisë së Kosovës.

Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, me datë 27.05.2019, me numër protokoll 181/2019, ka nxjerr vendim me të cilin ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa bazuar në ligj.

Ankuesi i pakënaqur me vendimin e datës 27.05.2019, me numër protokoll 181, të Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave të Këshillit të Sigurisë së Kosovës, brenda afatit ligjor në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-048, për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 02.07.2019, me numër protokoll 2974/2019, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimet ankimore lidhur me shqiptimin e masës disiplinore nga Komisioni Disiplinor i Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 05.07.2019, me numër protokoll 3035/2019 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të Këshilli i Sigurisë së Kosovës, ndërsa me datë 15.07.2019 me numër protokoll 3136/2019, Këshilli ka pranuar përgjigje në ankesë nga Këshilli i Sigurisë së Kosovës, me shkresat e bashkangjitura, 53 faqe.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga muaji janar i vitit 2019 deri më datë 08.10.2020 ka qenë jo funksional dhe nuk ka vendosur për ankesën e ankuesit, ndërsa më datë 03.09.2019 përmes shkresës të protokolluar më datë 05/09/2019, Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka njoftuar ankuesin për arsyet e mos shqyrtimit të ankesës duke udhëzuar që mund të ndiqni procedurat e mëtejme dhe se në pajtim me Ligjin për Konfliktin Administrativ mund të filloni procedurën gjyqësore pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative.

Ankuesi i pakënaqur me njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka hapur konflikt



administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, me datë 15.03.2021, me numër A.nr.2345/2019, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke e detyruar KPMSHCK-në që në afati prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit

Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën A.nr. 370/2019, e datës 02.07.2019, me numër protokoli 2974/2019, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; ankesën A.nr.233/2021, të datës 01.04.2021, sipas Aktgjykimit A.nr. 2345/2019, të datës 15.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative ;Vendimi i datës 26.03.2019, me numër protokoli 091/2019, i Komisionit Disiplinor; Vendimi i datës 27.05.2019, me numër protokoli 181/2019, i Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 22.03.2017,Nr.08/138;Aktvendimi AA.Nr. 224/2019, i Gjykatës së Apelit;Traskripti i Seancës dëgjimore;Ankesa e datës 24.04.2019,drejtuar Komisionit për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Procesverbali i seancës dëgjimore; Përshkrimi i detyrave të Punës;Akt Emërimi i datës 25.10.2012; e- maili i datës 03.10.2019; e-maili i datës 21.02.2019;Deklaratë e datës 28.02.2019; e- maili i datës 27.02.2019; e-maili i datës 27.02.2019; e-maili i datës 26.02.2019; e-maili i datës 27.02.2019; e-maili i datës 28.09.2017; e-maili i datës 29.08.2018; e-maili i datës 26.06.2016; Njoftim i datës 05.09.2019 i KPMSHCK-së; Përgjigje në Ankesë e datës 15.07.2019, me numër protokoli 3136/2019, me shkresat e bashkangjitura,53 faqe.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës,ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës fillimisht ka analizuar Aktgjykimin, me numër A.nr. 2345/2019, të datë 15.03.2021, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative, me të cilin Aktgjykim ka aprovuar kërkesë padinë e paditësit, duke e anuluar njoftimin e datës 03.09.2019, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe duke e detyruar që në afatin prej tredhjet (30) ditësh Këshilli të vendos lidhur me ankesën e ankuesit të datës 02.07.2019.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit se Komisioni Disiplinor i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, me datën 26.03.2019, me numër protokoli 091, ka nxjerr vendim me të cilin ka shqiptuar masën disiplinore „ Pezullim i ushtrimit të detyrës dhe ndalim i 1/3 të rrogës për periudhën një (1), mujore, të cilin e ka vërtetuar edhe Komisioni për Zgjedhjen e Kontesteve dhe Ankesave i Këshillit të Sigurisë së Kosovës me vendim me datën 27.05.2019, me numër protokoli 181/2019. Kolegji për shqyrtimin dhe



vendosjen e ankesës ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara në legjislacionin në fuqi që rregullojnë këtë çështje.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Këshillit të Sigurisë së Kosovës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 67, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ku në paragrafin 1 nëparagrafi 1.2.1 dhe 1.2.2 thuhet se: **1. Vetëm këto masa disiplinore mund të zbatohen për shkeljen e detyrave të përcaktuara me këtë ligj: 1.2. për shkelje të rëndë aplikohen masat disiplinore në vijim: 1.2.1. pezullimi parandalues me pagesë deri në tre (3) muaj në pritje të një hetimi i cili duhet të propozohet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë dhe miratohet nga organi përgjegjës për menaxhimin e personelit në institucion. 1.2.2. pezullimi i detyrave dhe ndalimi i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2) muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, si dhe në kundërshtim me nenin 8, paragrafi 1 nëparagrafi 1.2, të Rregullores Nr. 04/2017, për Procedurat Disiplinore në Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se; Për Shkelje të rënda Serioze të përcaktuara me nenin 6 të kësaj Rregulloreje , nëpunësit civil, mund t'i shqiptohet këto masa disiplinore pezullimi i ushtrimit të detyrave dhe ndalim i 1/3 të rrogës për një periudhë deri në dy (2), Muaj nga komisioni disiplinor pas kërkesës nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.** Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se nga shkresat e lendes del se nëpunësi civil ~~duke~~ ka bere shkelje të detyrave të punës, dhe nga shkresat e lendes del se nëpunësi civil, personalisht, ka njoftuar personat përgjegjës për kushtet e punës dhe ambientit në punë, përkatësisht me aromën e lëshuar nga ventilimet, duke lëshuar helm kimik dhe një majereje pluhur të kuqe.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës ka konstatuar se në deklaratën e dhënë të datës 28.02.2019, me numër protokollit 73, të Shaqir Shaqirit, me të cilin z, Shaqir Shaqiri, ka deklaruar se nga njëherë nga ventilimet lëshohet pluhur po nuk është e shpeshtë dhe se këto probleme ne si menaxhment, jemi duke i trajtuar me Ministrinë e Administratës Publike;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesës gjatë shqyrtimit të ankesës se ankuesit, ka marr për bazë nenin 42, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Kosovës ku thuhet se: **1. Çdo organ i punësimit duhet të garantojë që nëpunësit civilë të kenë një ambient të sigurt e të përshtatshëm pune. Ankesat dhe pakënaqësitë lidhur me ambientin e punës duhet t'i drejtohen menaxherit të burimeve njerëzore të organit të punësimit. 2. Organi i punësimit siguron kushte me të cilat mbrohet integriteti fizik dhe moral i nëpunësit civil.** Kolegji për shqyrtimin e ankesave ka konstatuar se nëpunësit civil Arben Ramadani, vazhdimisht për mes e-mailit ka njoftuar eproret për gjendjen e cila ka mbizotëruar sa i përket gjendjes së erës që ka mbizotëruar tek objektet e Këshillit të Sigurisë së Kosovës.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, ka konstatuar se Komisioni për Zgjidhjen e Kontesteve dhe të Ankesave i Këshillit të Sigurisë së Kosovës me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.181/2019 i datës 27.05.2019, si dhe Vendimi i datës 26.03.2019, me

numër protokoll 091, i Komisionit Disiplinor, është në kundërshtim me dispozitat e të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Ligjin Nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Rregulloren Nr. 05/2011 për Procedurat e Zgjidhjes së Kontesteve dhe Ankesave, duke mos vërtetuar drejtë gjendjen faktike dhe bazën juridike me rastin e nxjerrjes së këtyre dy vendimeve të atakuara me këtë ankesë, lidhur me ankesën e ankuesit

lidhur me vendimin për shqiptimin e masës disiplinore nga Komisioni Disiplinor.

Andaj bazuar në këto rrethana, Kolegji për shqyrtimin e ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës dhe provave të ofruara nga palët, si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga kryetari i kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda A.nr. 370/2019, datë 16/04/2021


Rushit KAJTAZI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Përfaqësuesit juridik avokatit Ekrem Agushi
- Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Sigurisë së Kosovës;
- Udhëheqësit të Personelit në Këshillin e Sigurisë se Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

